

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“HomeTech-AL” SHPK**

Në Tiranë, sot më datë **07/07/2021** në selinë e shoqërisë, me zyrë në adresën:

**Rruga Siri Kodra, Godinë 1 katëshe 40/1, Ish Godina e kartotekës, Njësia Bashkiake nr.9, Tiranë, Shqipëri,** u paraqit personalisht ortaku themelues si më poshtë:

**Z. Olsi Mehmetaj** shtetas Shqiptar, atësia **Fatmir** lindur më **20/02/1990** në **Fier** dhe banues në **Tiranë**, gjendja civile "**I martuar**", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim/Pasaportën me **Nr. Personal J00220078V**,

I cili harton këtë Akt Themelim të Shoqërisë "**HomeTech-AL**" SHPK, mbështetur në ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshtë:

**KREU I**

Neni 1  
*Krijimi*

Shoqëria "**HomeTech-AL**" SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptarë, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2  
*Personaliteti iuridik*

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**HomeTech-AL**" shpk. është një shoqëri, që themelohet ndërmjet ortakut të vetëm

**Z. Olsi Mehmetaj** që përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3  
*Selia*

Shoqëria e ka selinë në:

**Rruga Siri Kodra, Godinë 1 katëshe 40/1, Ish Godina e kartotekës, Njësia Bashkiake nr.9, Tiranë.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut/Ortakëve të Shoqërisë.





Neni 4  
*Objekti i veprimtarise*

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

**Import dhe Eksport të makinerive e materialeve të ndryshme elektronike, paisjeve elektroshtëpiake, paisjeve elektrike, makinerive industriale, makina etj. Tregëti me shumicë dhe pakicë të produkteve: elektrike, elektroshtëpiake, elektronike, ushqimore, makinerive industriale, makina etj.**

Neni 5  
*Kohëzgjatja*

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**KREU II  
KAPITALI**

Neni 6  
*Kapitali Themeltar*

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 leke (njëmijë lekë).

- a) Ortaku **Z. Olsi Mehmetaj** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1.000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shperblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

Neni 7  
*Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave*

Kuotat e kapitalit, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejten e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagësës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me perjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e Biznesit ose të publikimit të kontrates apo të kalimit të titullit.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### Neni 8

#### *Organi vendimmarrës*

Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vëtëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja Ortakut/Ortakëve të vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kesaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Kreditimin në çfarëdo bankë apo institucion financiar kreditor.
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.





Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9  
*Administrimi*

Shoqëria do të administrohet nga një administrator **Z. Olsi Mehmetaj** shtetas Shqiptar, atësia **Fatmir** lindur më **20/02/1990** në **Fier** dhe banues në **Tiranë**, gjendja civile "**I martuar**", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim/Pasaportën me **Nr. Personal J00220078V**, sipas statutit dhe ligjit për një periudhë **5 vjeçare** me të drejtë ripërtëritje. Asambleja e ortakut/ortakëve të vetëm, mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Pervç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.


Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10  
*Kompetencat*

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojë përpara asamblesë së ortakut/ortakëve të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligje dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqësonë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara





Bankave të të gjitha nivele, për të kryer derdhje, tërheqje, transferta, etj, perpara Zyrave të Tatim Taksave. Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërine në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11  
*Viti Financiar*

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12  
*Baza Ligjore*

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13  
*Mosmarrëveshjet*

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14  
*Dispozita përfundimtare*

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortaku/Ortakët e shoqërisë tregtare **"HomeTech-AL" shpk**, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKU THEMELUES

I SHOQËRISË **"HomeTech-AL" SHPK**

**Olsi MEHMETAJ**

